



Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

Në mbështetje të neneve 4 dhe 9 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Rregullores së Kuvendit të Komunës me Nr.15-110/04-11057 e datës 28.02.2023 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019 si dhe nenit 58 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari nxjerrë këtë:

SHPALLJE

I. Qëllimi i shpalljes për aplikim

Qëllimi i shpalljes për aplikim është përkrahja e fermerëve për vitin 2026, fermerët do të përkrahen me Sera me sipërfaqe prej 50m².

II. Kriteret e aplikimit për serrë

- Të jetë banorë i Komunës së Lipjanit
- Toka duhet të jetë në territorin e Komunës së Lipjanit.
- Të posedojë sipërfaqe të tokës bujqësore së paku 200m² dhe të jetë e përshatshme për ndërtimin e serrës.
- Përparësi në përzgjedhje kanë aplikuesit të cilët nuk kanë përfituar subvencione ne sera apo mekanizem tjetër bujqësor nga Komuna ose nga donatorët gjatë 5 viteve të fundit.
- Nuk lejohet përfitimi i dyfishtë brenda së njëjtës ekonomi familjare. Në rast se një anëtar i ekonomisë familjare ka përfituar nga kjo masë mbështetëse gjatë 5 viteve të fundit, anëtarët e tjerë të së njëjtës ekonomi familjare nuk kanë të drejtë të përfitojnë nga e njëjta masë gjatë kësaj periudhe.
- Aplikuesi duhet t'i përmbushë të gjitha kushtet dhe të dorëzojë dokumentacionin e kërkuar brenda afatit të përcaktuar në thirrjen publike.

III. Dokumentet e bashkangjitura

Aplikuesit duhet të dorëzojnë aplikacionin së bashku me dokumentet e bashkangjitura:

- Kopja e letërnjoftimit.
- Fletëposedim për patundshmëri (të jetë në emër të aplikuesit ose të ndonjë antari të familjes dhe të jetë origjinal). Dëshmi që vërteton afërsinë familjare.
- Dëshmi për pagesën e tatimit në pronë (të jetë origjinal).
- Çertifikatën e Bashkësisë Familjare (*kërkohet vetëm origjinal*).

IV. Koha dhe mënyra e pranimit të aplikacioneve

- Data e fillimit të dorëzimit të formularit për aplikim është dita pasi të jetë publikuar thirrja për aplikim,
- Thirrja për aplikim do të jetë e hapur 15 ditë kalendarike nga data e publikimit,
- Marrja e aplikacioneve si dhe dorëzimi i dokumentëve të bashkangjitura, bëhen në zyret pritëse të Arhives së Komunës

V. Përzgjedhja

- Pasi të kryhet kontrolli administrativ e aplikacioneve vazhdon verifikimi i aplikacioneve në terren nga komisioni,

Sqarim:

- Dokumentacioni për aplikim duhet të dorëzohet brenda periudhës së aplikimit. Dorëzimi i dokumentacionit pas përfundimit të afatit të publikuar dhe i pakompletuar, nuk do të pranohet për shqyrtim.

12Nr. 320/01-40477

Lipjan me: 14/08/2026

Drejtore i Bujqësisë

Rexhep Rexhepi





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E LIPJANIT
OPSTINA LIPJAN / MUNICIPALITY OF LIPJAN



Formulari për aplikim

APLIKACION PËR SERRË

Të dhënat për aplikuesin

Emri		Emri babës		Mbiemri	
Fshati		Rruga		Nr. Shtëpisë	
Numri telefonit					

Të dhënat për sipërfaqen e tokës dhe furnizimit me ujë

Sipërfaqja e tokës		Tokë nën ujitje	
Furnizim me ujë		Ujsjells	
Pusi		Burime tjera	

Arsyja që jeni i interesuar

Në aplikacion duhet të bashkëngjitni edhe dokumentet e nevojshme:

- Kopja e letërnjoftimit.
- Fletëposedim për patundshmëri (të jetë në emër të aplikuesit ose të ndonjë antari të familjes dhe të jetë origjinal). Dëshmi që vërteton afërsinë familjare.
- Dëshmi për pagesën e tatimit në pronë (të jetë origjinal).
- Çertifikatën e Bashkësisë Familjare (*kërkohet vetëm origjinal*).

Datë: _____

Vendi: _____

Nënshkrimi: _____